



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



ARTMOTION
Valon SHALA
Pronar
Prishtinë

Rasti Nr. 2017/11
Ref:1801/132/KPM/am

VENDIM

**Lidhur me Rastin Nr. 2017/11 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për ARTMOTION
("Pala Përgjegjëse")**

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01, e cila ka hyrë në fuqi më 28 korrik 2016. Me këtë Rregullore janë përcaktuar rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve, të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur, shpërndajnë përmbajtje audio dhe audiovizuale.
2. KPM me datën 14 shkurt 2017 ka pranuar një ankesë të parashtruar nga operatori i shpërndarjes IPKO ndaj Palës Përgjegjëse, duke pretenduar se është duke e ritransmetuar kanalën KLAN TV pa të drejta të ritransmetimit, kanal për të cilin IPKO pretendon që i ka të drejtat ekskluzive të transmetimit në Kosovë.
3. KPM, nëpërmes një shkrese me datën 20 shkurt 2017, e ka njoftuar Palën Përgjegjëse për ankesën e pranuar nga IPKO dhe e ka udhëzuar që brenda pesë ditësh të ofrojë dëshmi shtesë për të drejtën e ritransmetimit të kanalit në fjalë.
4. KPM me datën 2 mars 2017 ka pranuar një përgjigje nga Pala Përgjegjëse përmes së cilës potencohet se ata janë në negociatë të vazhdueshme me televizionin KLAN TV për vazhdimin e transmetimit të programeve të tij.
5. KPM në bazë të Raportit të monitorimit të datës 9 mars 2017 ka gjetur se IPKO dhe Pala Përgjegjëse i kanë deponuar marrëveshjet sipas të cilave pretendojnë se i kanë të drejtat e transmetimit të KLAN TV. KPM, pas vlerësimit ligjor ka gjetur se IPKO i posedon të drejtat ekskluzive të ritransmetimit të kanalit KLAN TV, të lëshuara nga vetë mbajtësit e këtyre të drejtave, pra KLAN TV. Ndërsa, Pala Përgjegjëse e posedon një marrëveshje të lidhur me MEDIA 21 dhe SMART WORLD TV për ritransmetimin e kanalit KLAN TV,

mirëpo këto të fundit nuk janë të autorizuar që të bëjnë rishitjen e kanaleve në fjalë nga bartësit e të drejtave të tyre.

6. KPM, pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 15 mars 2017 i ka dërguar Palës Përgjegjëse Njoftim për Shkelje me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe i ka kërkuar të veprojë në pajtim me Rregulloren KPM-2016/01, duke e ndërprerë menjëherë ritransmetimin e kanalit KLAN TV. Po ashtu, në Njoftim paralajmërohet që të ndërmarrë masa urgjente që një gjë e tillë të mos përsëritet, sepse në të kundërtën Komisioni i KPM-së do të ndërmarrë masa ligjore në pajtim me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.
7. KPM, për të verifikuar pajtueshmërinë e Palës Përgjegjëse me Rregulloren KPM-2016/01 pas Njoftimit për Shkelje, ka iniciuar edhe një monitorim shtesë me datë 21 mars 2017 në selinë e Palës Përgjegjëse. Në bazë të Raportit të monitorimit, të datës 21 mars 2017, KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse nuk e ka larguar kanalën KLAN TV nga platforma e vet.
8. KPM me datën 21 nëntor 2017 ka pranuar një shkresë nga Pala Përgjegjëse në të cilën potencohet se ata janë në negociatë direkte me televizionin KLAN TV për vazhdimin e bashkëpunimit dhe duke kërkuar një afat shtesë prej 30 ditësh me qëllim të lidhjes së kontratës ndërmjet KLAN TV dhe Palës Përgjegjëse për të drejtën e transmetimit të KLAN TV.
9. KPM në bazë të Raportit të monitorimit të datës 22 dhjetor 2017 ka gjetur se Pala Përgjegjëse vazhdon të ritransmetojë kanalën KLAN TV pa marrëveshje valide për të drejtën e ritransmetimit.

Analiza Ligjore

10. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton Pala Përgjegjëse është gjetur në shkelje të nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01.

Neni 4, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2016/01 përcakton se:

“I licencuari obligohet të bëjë shpërndarjen e ofruesve të shërbimit medial bazuar vetëm në marrëveshje valide për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale.”

11. Komisioni konstaton se duke u bazuar në raportet e monitorimit Pala Përgjegjëse ka dështuar që të marrë hapa të nevojshëm për të ardhur në pajtueshmëri me nenin 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01.
12. Komisioni duke u bazuar në faktet e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka deponuar marrëveshje për transmetimin e KLAN TV, por pas vlerësimit ligjor është gjetur se ato nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme për transmetimin e këtij kanali. E drejta e transmetimit i është dhënë nga MEDIA 21 dhe SMART WORLD TV, por nga verifikimi i kontratave nga KPM dhe siç është vërtetuar nga vetë bartësit e të drejtave të KLAN TV, ata nuk e kanë autorizuar asnjë palë për t’ia kaluar të drejtat e ritransmetimit të këtij Palës Përgjegjëse.

13. Komisioni konstaton se Pala Përgjegjëse edhe përkundër Njoftimit për shkelje ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01, duke e transmetuar kanalën KLAN TV pa marrëveshje valide.
14. Komisioni gjithashtu konstaton se Pala Përgjegjëse edhe pas kërkesës së KPM-së nuk e ka ndërprerë transmetimin e kanalit KLAN TV, veprim ky i cili bie ndesh me nenin 5, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2016/01 i cili përcakton se:
- “Kur i licencuari gjen se një shërbim i programit ka përmbajtje ilegale, i licencuari duhet menjëherë ta ndërpresë shpërndarjen e mëtutjeshme të përmbajtjes ilegale dhe të ndërmarrë masa që të sigurohet se një gjë e tillë nuk do të përsëritet”*
15. Komisioni konstaton se edhe përkundër kërkesës së Palës Përgjegjëse për një afat shtesë prej 30 ditësh për të siguruar të drejtën e transmetimit të kanalit KLAN TV, Pala Përgjegjëse nuk ka arritur që të sigurojë marrëveshje valide dhe ka vazhduar ta ritransmetojë kanalën KLAN TV.
16. Prandaj Komisioni duke u bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura vlerëson se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të vazhdueshme të nenit 4, paragrafi 1 dhe të nenit 5, paragrafi 3 të Rregullores KPM-2016/01.

Vendimi

17. Komisioni bazuar në nenin 5, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2016/01 të urdhëron Palën Përgjegjëse të ndërpresë menjëherë transmetimin e kanalit KLAN TV.
18. Në rast se Pala Përgjegjëse edhe pas pranimit të këtij vendimi nuk e heq kanalën KLAN TV nga platforma e shpërndarjes ashtu siç përcaktohet me nenin 5, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2016/01, Komisioni do të ndërmarrë masa tjera sanksionuese ndaj Palës Përgjegjëse, në pajtueshmëri me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.

E drejta për Ankesë

19. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkojnë nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
20. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Adnan MEROVCI
Kryetar



31.01.2018
Datë